



Prishtinë: 28.12.2012

Kodi i ZRRE-së: V\_493\_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_878\_11\_12

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_878\_11\_12**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 12.12.2012;

**Në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2012, nxori këtë:**

#### VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M.B (shifra në KEK: DPZ – 9498) nga Prizreni ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_878\_11\_12 i datës 06.11.2012

#### Arsyetim

Me datë 24.03.2011 konsumatori me shifër DPZ – 9498 ka bërë një pagesë në KEK për kontrollimin e njehsorit elektrik. Pas kësaj pagese punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datës 05.04.2011 kanë dalur për kontrollim te konsumatori me shifër DPZ -9498 për të bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 4747797 dhe për matje kanë vendosur njehsorin elektrik të KEK-ut nr. 17693464.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut në Qendrën e Kalibrimit me datës 08.06.2011 kanë bërë verifikimin detal të njehsorit elektrik dhe gjatë verifikimit kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 4747797 bllombat shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur asnjë parregullsi. Përveç kontrollimit detal punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë edhe shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 4747797 dhe gjatë shqyrtimit kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes së energjisë elektrike.

Pas kësaj konsumatori me shifër DPZ – 9498 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK lidhur me mos saktësinë e njehsorit elektrik. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 06.11.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar** ankesën e konsumatorit.



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, konsumatori me shifër DPZ - 9498 më datë 10.10.2012 ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_878\_11\_12 të datës 06.11.2012. Konsumatori në ankesë thekson se ankesa e konsumatorit drejtuar KEK-ut ka qenë analizimi dhe korrigjimi i faturave të energjisë elektrike, si dhe konsumatori të vazhdoj të pagesat e rregullta sipas shpenzimeve reale. Konsumatori thekson se dyshon në shtimin e dyfishtë të shumës së shpenzuar të energjisë elektrike si pasojë e ndonjë defekti të njehsorit të rivendosur të cilët ekspertët nuk kanë qenë në gjendje të zbulojnë dhe ta eliminojnë defektet në llogaritjet e bëra gjatë regjistrimit të gjendjes në kompjuter. Konsumatori në vazhdim të ankesës thekson se gabimet munden me qenë edhe në momentin e njehsorit të ri ku shënohet rritja e shpenzimit të energjisë në njehsorin e ri në krahasim me njehsorin e vjetër për 75%, çka kurrsesi nuk mundet me qenë reale, mbasi rrethanat kanë mbetur të njëjta.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2012 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilin pretendohet se DMK gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar saktë gjendjen faktike si dhe ka gabuar në dispozitat ligjore dhe të akteve tjera normative. Bordi i ZRRE-së konstaton se pretendimet e konsumatorit të theksuara në ankesë nuk tregojnë dhe nuk argumentojnë saktë shkeljet e bëra nga DMK. Bordi i ZRRE-së vlerëson se DMK ka analizuar të gjitha faktet e prezantuara nga konsumatori dhe KEK-u dhe ka vlerësuar të gjitha pikat e ankesës së konsumatorit. Bordi i ZRRE-së ka analizuar dëftesë pagesën e bërë nga konsumatori nr. DPZ11MC0323711654/111 të datës 24.03.2011, procesverbalet e qendrës së kalibrimit nr. 17/07 i KEK-ut i datës 07.06.2011 si dhe protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 014719 i KEK-ut datës 08.06.2011 dhe ka vërejtur se: kur konsumatori ka bërë pagesën në KEK për ndërrim njehsori nën dyshimin e saktësisë së njehsorit elektrik, në atë kohë njehsori elektrik i vendosur ka qenë njehsori elektrik nr. 4747797, si dhe sipas qendrës së kalibrimit është vërejtur se ky njehsor elektrik ka qenë brenda kufijve të lejuar të matjes së energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të kësaj shifre sipas muajve dhe viteve, dhe gjatë analizimit ka vërejtur se konsumatori me shifër DPZ – 9498 nga periudha 08/2002 e gjerë më sot ka pasur në funksion disa njehsor elektrik: nga periudha 08/2002 e deri më 07/2003 ka pasur në funksion njehsorin elektrik nr. 2917079, pas kësaj nga periudha 08/2003 e deri më 04/2004 ka pasur në funksion njehsorin elektrik nr. 2695708, pastaj prej periudhës 05/2004 e deri 06/2004 ka pasur në funksion njehsorin elektrike nr. EK 31974287; prej periudhës 07/2004 e deri më 08/2007 konsumatori ka pasur në funksion njehsorin elektrik nr. 7743281; prej periudhës 09/2007 deri më 04/2011 ka pasur njehsorin elektrike nr. 4747797 dhe prej periudhës 04/2011 e tutje ka njehsorin elektrik nr. EK 17693464. Pra nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike bërë njehsorëve elektrik të cilat i ka pasur në funksion konsumatori me shifër DPZ – 9498 shihet se mesatarja mujore e shpenzimit të këtyre njehsorëve të energjisë elektrike janë: njehsori elektrik nr. 2917079 (08/2002 – 07/2003) = 493 kWh/muaj; njehsori elektrik nr. 2695708 (08/2003 – 04/2004) = 565 kWh/muaj; njehsori elektrik nr. 31974287 (05/2004 – 06/2004) = 245 kWh/muaj; njehsori elektrik nr. 7743281 (07/2004 – 08/2007) = 527kWh/muaj; njehsori elektrik nr 4747797 (09/2007 - 04/2011) = 599 kWh/muaj; njehsori elektrik nr. 17693464 (04/2011 – 08/2012) – 1048 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut, ku sipas listave të leximit të KEK-ut vërehet se lexuesi i KEK-ut në listën e leximit të periudhës 03/2010 ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 4747797 është në rregull si dhe ka vulën distributive në rregull; në listat e leximit të KEK-ut prej periudhës 04/2010 e deri më 01/2011 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 4747797 si dhe vula distributive janë në rregull; lexuesi i KEK-ut në listën e leximit të periudhës 02/2011 ka evidentuar se njehsori elektrik nr. 4747797 është në rregull ndërsa ka evidentuar se kemi vulë distributive tjetër; në listën e leximit të KEK-ut të periudhës 03/2011 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se



njehsori elektrik nr. 4747797 është në rregull si dhe ka vulën distributive në rregull; në listën e leximit të KEK-ut të periudhës 04/2011 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se kemi ndërrim njehsori elektrik.

Sipas nenit 5.11.1 të Kodit të Matjes, theksohet se: *“Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të **njehsorit**. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 1.5 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për **njehsorët** e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0 %, kufiri i lejuar do të ishte 3.0%) atëherë bëhet ri–Ilogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit. Kur vendoset **njehsori** kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë atëherë veprohet siç e thamë më lartë”*.

Sipas nenit 32 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike theksohet se: *“pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”*.

Sipas nenit 4.9.1 të Kodit të Matjes, theksohet se: *“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bënë testimin e njehsorëve sipas planit të rregullt dhe ad-hoc ose sipas kërkesës së bërë nga ana e konsumatorit (ky testim nuk mund të bëhet më shpesh se një herë në 2 (dy) vite, çdo kërkesë nga ana e konsumatorit, në afatin më të shkurtër siç është përcaktuar më parë, shpenzimet do të barten nga ana e tij)”*.

Bordi i ZRRE-së thekson se vendimi DMK është bazuar në analizat e procesverbaleve të KEK-ut dhe shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorëve të energjisë elektrike të cilat i ka pasur në funksion konsumatori me shifër DPZ – 9498, dhe se procesverbalet e kontrollimit të saktësisë së njehsorit elektrik janë bërë për njehsorin elektrik nr. 4747797 për të cilën ju si konsumator me datë 24.03.2011 keni bërë pagesën për kontrollimin e këtij njehsori elektrik. Bordi i ZRRE-së, udhëzon konsumatorin se në rast dyshimit për matje jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 17693464 të vendosur nga ana e KEK-ut, konsumatori fillimisht duhet të parashtrij kërkesë në KEK për shqyrtim të njehsorit elektrik dhe pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, dhe në rast se nuk pajtoheni me këtë përgjigje, ju mund të parashtroni ankesë në ZRRE. Me këtë rast ZRRE mbi bazën e vlerësimeve rreth gjendjes teknike të këtij njehsori elektrik mund të jap vlerësimet lidhur me këtë njehsor elektrik që është objekt diskutimi e jo për njehsor elektrike që nuk janë objekt shqyrtimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK\_V\_878\_11\_12**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar